



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE**

**SHPLLJE PËR KONKURSION E HAPUR PËR PROFESIONISTË TË SHKENCAVE TEKNIKE  
MJEKËSORE**

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 493, datë 13.11.2017 “Për administrimin e procedurave të punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë”, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale **shpall konkursin e hapur për profesionistë të shkencave teknike mjekësore** në institucionet shëndetësore publike në Republikën e Shqipërisë.

**Afati për aplikim është deri me datë 31/12/2018**

**Aplikimi do të kryhet në platformën on-line “Infermier për Shqipërinë”**

Tabela me profilet e kërkuara sipas Qarqeve:

Qarqet	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Shkodër	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik Imazherie	Teknik laborator
Kukes	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Lezhe	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik Imazherie	Teknik laborator
Diber	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Durres	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Elbasan	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Berat	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Korce	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik Imazherie	Teknik Laboratori
Tirana	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Fier	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Vlore	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator
Gjirokaster	Infermier	Mami	Fizioterapist	Teknik imazherie	Teknik laborator

Kjo shpallje bëhet me qëllim krijimin/përtëritjen e listës së pritjes, sipas qarqeve për profesionet e shkencave mjekësore teknike.

Fituesit që janë aktualisht në listë pritje do të vazhdojnë të punësohen sipas radhës deri në daljen e fituesve nga konkurimi i radhës. Kandidatët që do të mbeten në listë pritje do të ripozicionohen sipas pikëve që kanë. Ata gjithashtu mund të futen në konkurim për të ndryshuar pikët e tyre, në fund të konkurimit do ju njihen pikët që do kenë nga ky proces.

**Dokumentet e domosdoshëm për aplikim** për profesionistët e shkencave mjekësore teknike:

- Curiculun vitae, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, të udhëzimit nr. 493;
- Raport mjeko- ligjor i tre muajve të fundit (në momentin e punësimit);
- Deklaratë për gjendjen gjyqësore, sipas shtojcës 5 bashkëlidhur udhëzimit nr. 493;

- d. Fotokopje e diplomave dhe lista e notave për çdo diplomë (e detyrueshme);
- e. Fotokopje e noterizuar e lejes së ushtrimit të profesionit (e detyrueshme) ;
- f. Fotokopje e librezës së punës e noterizuar (nëse ka);
- i. Fotokopje të noterizuara të dëshmisë/ve së njohjes së gjuhës/ve të huaja (nëse ka);

### **Vlerësimi i kandidatit**

Vlerësimi bëhet me dy faza:

- a) Faza parë, vlerësimi i dosjes deri në 30 pikë;
- b) Faza e dytë, testimi me shkrim deri në 70 pikë;

Testi me shkrim përbëhet nga dy pjesë:

Pjesa e parë përmban pyetje rreth akteve ligjore:

- Ligji nr.10 107, datë 30.3.2009 “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr.9718, datë 19.4.2007 “Për Urdhrin e Infermierit në Republikën e Shqipërisë”.

Pjesa e dytë përmban pyetje bazë rreth profesionit.

Vlerësimi i testit bëhet me sistemin e 70 pikëve.

Duke filluar nga data 3/1/2019, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të shpallë në portalin “Infermier për Shqipërinë”, listën paraprake të kandidatëve që kualifikohen për vazhdimin e procedurës së testimit me shkrim.